

VENDIM
Nr. 123, datë 6.5.2026

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1”
SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË
GARANCIVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË
PRODHIMIT PËR CENTRALIN FOTOVOLTAIK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 1040/3 prot., datë 5.5.2026, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për centralin fotovoltaik me kapacitet 20 mw, në Njësinë Administrative të qendrës Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 231, datë 30.10.2024.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., me shkresën nr. 1040/2 prot., datë 23.4.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik, si dhe kërkesën për pajisjen me garanci të origjinës për prodhimin e gjeneruar nga impianti fotovoltaik “Erseka Solar Park 1” për periudhën janar 2026– mars 2026.

- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.

- Sa më sipër cituar, kjo shoqëri fillimisht, me shkresën nr. 1040 prot., datë 1.4.2026 ka përcjellë në ERE “Kërkesë për pajisje me GO për prodhimin e gjeneruar nga impianti fotovoltaik ‘Erseka Solar Park 1’, për periudhën dhjetor 2024–dhjetor 2025”.

- ERE, në përgjigje të kërkesës, me shkresën nr. 1040/1/1 prot., datë 14.4.2026, i ka bërë me dije shoqërisë se në zbatim të nenit 6, të rregullores në fuqi, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024, shoqëria duhet të paraqesë në fillim kërkesën për krijimin e një llogarie në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, së bashku me të dhënat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni dhe se referuar përcaktimeve të pikës 7, të nenit 12 të rregullores, garancia e

originës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

- Pas miratimit/vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, shoqëria do të njoftohet në mënyrë që të publikojë në portal sasitë e energjisë elektrike të prodhuara për muajt janar–mars 2026, për të cilat kërkon dhe lëshimin e GO.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistrë elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.

- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaik për të cilin kërkohet regjistrimi klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës, sipas nenit 6 të rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.

- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistrë si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në kategorinë prodhues dhe tregtar i energjisë elektrike, dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti